

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZGLATVANJE NABAVKI
Nr/Bj. 294/19
Date/Datum. 10.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **328-19-1403-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi dhe montimi Klimave për SKGjK dhe Gjykata**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ALFA.I SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr. Ibrahim Rugova pn.

(Adresa)

Lipjan

14 000

(Vendi)

00383 38 606 706

(Kodi postar)

N/A

(Numri Telefonit)

Lulzim JAHAJ

(Numri i Faks-it)

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@alfa-i.com

(Adresa elektronike)

10.06.2019

(Data e parashtrimit të ankesës)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me **PROKURË**.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 21.03.2019

Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 16.04.2019 në 14:00:00

Data e hapjes së ofertave: 16.04.2019 në 14:00:00

Njoftimi mbi vendimin e AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit: 29.05.2019

Kërkesa për rishqyrtim dt:31.05.2019

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim 03.06.2019

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

E kemi pranuar Procesverbalin e Hapjes përmes E-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐



6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Gjeni te bashkangjiture KËRKESË PËR RISHQYRTIM si dhe Vendimin e Autoriteti Kontraktues.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 62 i LPP-së

Neni 44.7 dhe 8 i Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për Prokurim Publik (RRUOPP)

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar, ne jemi njoftuar me dt:29.05.2019 me vendimin të autoritetit kontraktues për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, ndërsa si arsye e kanë dhënë se një shkelje e ligjit ka ndodhur dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi. Ne me dt:30.05.2019 kemi pasur qasje në dokumentet e dy operatorëve ekonomik me çmim më të lirë se ne, tek oferta e OE "ENG HOUSE COMPANY" SH.P.K- Prishtinë dhe OE "AS Tech " SH.P.K"- PRISHTINË.

Ne si operator ekonomik dhe si palë me interes në këtë procedurë, nuk e dim arsyen e saktë se përse është anuluar ky aktivitet i prokurimit dhe se çfarë shkelje e ligjit ka ndodhur, mirëpo konsiderojmë se në këtë fazë të aktivitetit të prokurimit nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e parashikuara në nenin 62 të LPP-së dhe në nenin 44.7 dhe 8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP), prandaj vlerësojmë se ky aktivitet i prokurimit është anuluar pa bazë ligjore.

Fillimisht (herën e parë) është rekomanduar për kontratë "ENG HOUSE COMPANY" SH.P.K- Prishtinë, dhe ne kemi pasur qasje në dokumente dhe njëherit i kemi paralajmëruar Ak, se ky operator ekonomik nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, sepse në sqarimin që është dhënë në dosje si në vijim" Klimat e reja duhet të janë me sistem të ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C, ne e kemi vërejtur se OE "ENG HOUSE COMPANY" SH.P.K- Prishtinë e ka ofruar klimën ku sistemi i ngrohjes mund të funksionojë deri në - 7 °C, prandaj ky operator ekonomik është i përgjegjshëm.

Sa i përket operatorit ekonomik "AS Tech " SH.P.K"- Prishtinë, gjatë qasjes në dokumente të këtij operatori ekonomik, kemi vërejtur se i njëjti nuk e plotëson kërkesën e nenit 9.1&9.2 të FDT-së në lidhje me Kapacitetin teknik dhe profesional, ku është kërkuar si dëshmi dokumentare Katalogu me përshkrime, ndërsa ky operator ekonomik i ka ofruar disa fotografi kopje, e të cilat nuk përmbajnë asnjë përshkrim siç është kërkuar në dosje të tenderit. Pra as fotografitë nuk mund të llogariten si katalog, ndërsa përshkrime nuk ka fare, kurse neni 39.8 i RrUOPP parashih qartë se "Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara ---Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm".

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, rezulton se dy operatorët ekonomik me çmim më të lirë se ne, janë të përgjegjshëm.

Përfundimisht autoriteti kontraktues e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit pa asnjë mbështetje ligjore dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 62 të LPP-së dhe me dispozitat e nenit 44.7 dhe 8 të RrUOPP.

Gjithashtu ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, duke u diskriminuar ne si kompani e përgjegjshme dhe me çmim më të ulët në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Në vendimin e AK-së të dt:03.06.2019 për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, AK-ja është munduar që edhe ofertën tonë ta paraqes si ofertë të përgjegjshme, edhe pse ne jemi shpallur si tenderues i pasuksesshëm me arsyetim se ne nuk i kemi pasur katalogjet e nënvizuara, ju njoftojmë që kjo kërkesë nuk ka qenë në dosje të tenderit, por kërkesa ka qenë te prezantojmë katalogjet me përshkrime, ku katalogjet tanë i kanë të gjitha përshkrimet siç kërkohet në dosje të tenderit. Gjithashtu procesi i vlerësimit të tenderëve është mbyllur në momentin e dërgimit të letrave standarde.

Ne si operator ekonomik i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe nuk kemi ofruar me variante, siç bënë përpjekje tani AK-ja ta paraqet situatën dhe gjendjen, se ne kinse kemi ofertuar me variante. Ne i plotësojmë të gjitha specifikimet teknike ashtu siç janë kërkuar.

Në fund kërkojmë nga OSHP-ja, që të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e OE Alfa i, si e bazuar

ANULOHET njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.



Gjithashtu kërkojmë nga OSHP, që ta detyroni autoritetin kontraktues të bëjë rivlerësimin e ofertave sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, sepse ne si kompani i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe duhet të shpallemi fitues të këtij tenderi.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operatore Ekonomik na janë bërë dëme materiale dhe jomateriale. Për parapërgatitjen, përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, shpenzime të letrës, stafit që kanë përgatitur ofertën, shpenzimet e sigurimit të tenderit, shpenzime të shërbimeve si noterizimet, shpenzimet e transportit, përgatitjes së kërkesës për rishqyrtim, ankesësetj, diku në vlerë prej 3,000.00 €.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

